

Përqendrim me të cilin Interneshenal Pejper Kompani SHBA do të fitojë kontrollin mbi

DS Smith Plc, Mbretëria e Bashkuar

(lënda nr. 08-117/2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 13.08. 2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Interneshenal Pejper Kompani, me seli të regjistruar në 6400 Poplar Avenue, Memfis, Tenesi 38197, Shtetet e Bashkuara të Amerikës *synon të fitojë kontroll të pavarur drejtpërdrejt mbi*, DS Smith Plc, me seli të regjistruar në katin e 3-të, 1 Pedington Skver, Londër, Mbretëria e Bashkuar W2 1DL me anë të blerjes së aksioneve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Interneshenal Pejper Kompani është një shoqëri globale dhe lidere e letrës dhe paketimit, aktive në prodhimin e ambalazheve me bazë fibrash të rinovueshme, celulozës dhe produkteve të letrës, duke përfshirë kartonin e veshur dhe të pa veshur, kartonin dhe ambalazhet e valëzuar.

Interneshenal Pejper Kompani nuk ka shoqëri të regjistruara të lidhura në Maqedoninë e Veriut.

DS Smith Plc është shoqëria mëmë e fundit e Grupit DSS ("**Grupi DSS**"). Grupi DSS është një furnizues ndërkombëtar i paketimeve të qëndrueshme me bazë fibrash kryesisht në Evropë dhe Amerikën e Veriut, i cili mbështetet nga operacionet e riciklimit dhe prodhimit të letrës.

Grupi DSS përfshin një shoqëri të regjistruar të lidhur - Shoqëria për prodhimin e letrës dhe ambalazhit DS Smith AD Shkup, me seli në rr. 1632 nr. 1, Shkup - Gazi Babë, Gazi Babë, Maqedonia e Veriut dhe me aktivitetin e regjistruar DS SMITH AD - Prodhim i letrës dhe kartonit të valëzuar dhe i ambalazheve letre dhe kartoni.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se si tregje relevante për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si një treg për furnizimin e paketimeve të valëzuara dhe një treg për fibrat celuloze.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

16.08.2024

Shkup